

RISHIKIM DHE PERSPEKTIVË

Menaxhimi i Detyrimeve Tatimore dhe Strategjia për
Vitin 2026

Now, for tomorrow.



Hyrje

Ky material i përgaditur nga **ekspertë** të kontabilitetit, tatimeve, auditimit dhe zhvillimit të biznesit nga **Baker Tilly Kosovo**, synon t'i ndihmojë bizneset në Kosovë që të planifikojnë mbylljen e **suksesshme** të vitit 2025 dhe planifikimin strategjik për vitin 2026.

Ekonomia dhe Ligji Komericial.

Ekonomia e Kosovës ka reflektuar pozitivisht ndaj ndryshimeve dinamike të ekonomisë botërore, bazë e qëndrueshme për zhvillim të bizneseve. Parashikimet e rritjes ekonomike janë pozitive, mesatarisht prej 3.8% deri në 4.2% (Banka Botërore, 2024; Banka Qendrore e Kosovës, 2024). Banka Botërore parashikon rritje deri në 3.8% përderisa Banka Qendrore e Kosovës tregon vlera më ambicioze, me pritshmëri deri në 4.2% rritje në vitin 2026 (Banka Botërore, 2024; Banka Qendrore e Kosovës, 2024).

Kjo rritje mbështetet nga aktivitete të larta të konsumit dhe investimeve por bazohet edhe në pritshmëritë për zbutjen e inflacionit.

Kosova ka fituar vlerësimin kreditor sovran 'BB' në vitin 2024 (Standard & Poor's, 2024), duke shënuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe duke mbështetur profilin e Kosovës si treg me zhvillim strategjik financiar. Ky vlerësim merr parasysh nivelin e ulët të borxhit shtetëror dhe efikasitetin e sektorit bankar, duke shërbyer si sinjal për investitorët ndërkombëtarë.





Rreziqet dhe Mangësitë Strategjike.

Në rastin e Kosovës, burimet e lartëcekura kanë edhe mangësitë e tyre. Rritja ekonomike në Kosovë varet ndjeshëm prej remitancave nga diaspora, të cilat përbëjnë përafërsisht qerekun e bruto produktit vendor (BPV/GDP) (Banka Botërore, 2024) dhe lidhen kryesisht me konsumin privat. Ndër të tjera, ekonomia varet edhe nga tregjet e jashtme, me mungesë të balancit mes importit dhe eksportit të mallrave. Kosova duhet të orientohet në drejtë rritjes së prodhimit dhe eksportit.

Pengesat kryesore vazhdojnë të jenë të pranishme; ekonomia informale, niveli i ulët i integritetit rajonal dhe shkalla e lartë e papunësisë (Banka Botërore, 2024). Prandaj, menaxhimi efikas i detyrimeve tatimore dhe planifikimi strategjik bëhen vendimtarë për të ruajtur stabilitetin financiar.

Mbyllja e vitit fiskal:

Kontabiliteti dhe Detyrimet Tatimore.



Procedurat e reja nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Ligji Nr. 08/L-257 për administrimin e procedurave tatimore në Kosovë, i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2024, përmban disa ndryshime procedurale në deklarimin e detyrimeve tatimore gjatë mbylljes së vitit fiskal (ATK, 2024). Këto ndryshime kanë për qëllim përshpejtimin e proceseve dhe minimizimin e gabimeve.

Nën rregulloren e re, tatimpaguesit kanë të drejtë të paraqesin deklaratat e korrigjuara brenda tre viteve prej afatit të deklarimit të tatimeve (ATK, 2024). Administrata Tatimore e Kosovës vazhdon të ruajë të drejtën e vlerësimit dhe auditimit të deklarimeve për periudha deri në gjashtë vite, në raste normale (ATK, 2024). Ky ndryshim rëndon përgjegjësinë e tatimpaguesit për saktësinë e raporteve, pasi periudha për korrigjim është shkurtuar por fuqia e ATK për auditimin e tyre mbetet e njëjtë. Si rezultat, raportet financiare dhe llogaritjet tatimore duhet të jenë të sakta dhe të gatshme për auditim prej momentit të deklarimit.

Sipas rregullores së brendshme të ATK-së, kërkesat për kthim do të shqyrtohen brenda 30 ditëve kalendarike prej dërgimit të kërkesës (ATK, 2024). Ligji i ri ka ndryshuar edhe sistemin e gjobave duke vendosur ndarje më të qartë të gjobave sipas kategorisë së tatimpaguesit. Ndër të tjera, ATK tani ka edhe kompetenca për vendosjen e masave administrative si refuzimi apo ndalimi i statusit të regjistrimit në raste të parregullësive nga drejtuesit dhe vendosjen e sanksioneve në aktivitete tregtare të bizneseve në raste të eskaluara.

Kompleksiteti i rregullores së re rrezikon qëndrueshmërinë e bizneseve të cilat nuk kanë strategji të kontabilitetit. Prandaj, respektimi i rregullave dhe afateve për deklarimet tatimore garanton vazhdimësi efikase të aktiviteteve. Për t'u shmangur rreziqeve nga mangësitë në deklarime dhe për të përdorur ligjin në dobi të biznesit, kompanitë duhet të kenë strategji dhe sisteme të kontabilitetit të cilat garantojnë mirëqenien financiare dhe maksimizimin e mundësive të optimizimit të profitit.

Integriteti Financiar dhe Kërkesat në Raportimit.

Tatimi mbi fitim në Kosovë vazhdon të ketë normë 10% (ATK, 2024). Tatimpaguesit kanë kohë deri në tre muaj pas fundit të vitit financiar (zakonisht 31 Mars) për të dërguar kërkesat për kthime lidhur me tatimin mbi fitim dhe për të përfunduar obligimet.

Për të zvogëluar rrezikun ndaj detyrimeve tatimore, klientëve ju kërkohet të mos ndërmarrin vendime të painformuara, të cilat rezultojnë në parregullësi të dokumentacionit financiar ose në disbalancë ndërmjet pasqyrave financiare dhe atyre bankare. Verifikimi i rregullt i pasqyrave financiare me ato bankare ndihmon identifikimin e transaksioneve të gabuara- hapi i parë për deklaram të saktë dhe shmangie të problemeve me ATK.

Tatimpaguesit korporativ që synojnë zbritjen e borxhit të pashlyeshëm duhet të implementojnë strategji të detajuara dhe të kenë ekupe të koordinuara të kontabilitetit.



Sfidat e navigimit të standardeve të BE.

Ekonomia kosovare vazhdon integrimin në tregun Evropian. Prandaj, kriteret e BE-së për zhvillim të qëndrueshëm pritet të jenë kushte de facto për aktivitetet ekonomike në zonën e BE-së, edhe pse Kosova nuk është anëtare (Komisioni Evropian, 2025).

Vala e dytë e CSRD është shtyrë në vitin 2028 (Komisioni Evropian, 2025), por kjo pauzë nuk duhet të keqinterpretohet si arsye për të injoruar detyrimet thelbësore të raportimit.

Transpozimi i Direktivës për Kujdesin e Detyrueshëm të Qëndrueshmërisë Korporative (CSDDD) paraqet një kërkesë të menjëhershme për përputhje operacionale — sfidë direkte për bizneset kosovare që eksportojnë në BE (Komisioni Evropian, 2025). Kjo direktivë krijon obligim ligjor që ndërmarrjet të garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe standardeve mjedisore përgjatë të gjithë zinxhirit global të vlerës, përfshirë edhe kompanitë jo-anëtare të BE-së që eksportojnë në BE.

Bizneset kosovare duhet të ndërmarrin masa proaktive për të identifikuar ndikimet faktike dhe potenciale mbi të drejtat e punëtorëve dhe mjedisin, në mënyrë që të ruajnë qasjen në tregun e BE-së si destinacion eksporti.

Planifikimi Strategjik për vitin 2026.



Planifikimi strategjik për vitin 2026 ndihmon bizneset të përgatiten për të kapur mundësitë duke minimizuar rreziqet. Rëndësia e sektorit privat si shtyllë stabiliteti ekonomik po rritet.

Ndërmarrjet ndërkombëtare si Baker Tilly Kosovo duhet të kenë parasysh reformat globale tatimore, edhe nëse ligji vendor nuk ndryshon. Pavarësisht normës 10% të tatimit mbi fitim në Kosovë (ATK, 2024), bizneset që operojnë në juridiksione si BE-ja dhe SHBA-të duhet të përshtaten me ndryshimet tatimore globale që hyjnë në fuqi në 1 Janar 2026 (OECD, 2025).

Koordinimi ndërfunksional brenda rrjeteve ndërkombëtare siguron përputhshmëri dhe efikasitet në modelimin e aktivitetit ekonomik.

Infrastruktura Themelore.

Rritja ekonomike kërkon rritje të konkurrueshmërisë në sektorin privat dhe ulje të varësisë nga remitancat (Banka Botërore, 2024). Kosova ka mangësi të investimit në energji, infrastrukturë dhe kapital njerëzor. Duke pasur vlerësimin BB të kredisë sovrane (Standard & Poor's, 2024), bizneset kanë nevojë për këshillim në strukturimin e kapitalit, vlerësimin e biznesit, analizat e fizibilitetit dhe përgatitjen e planeve të investimit.

Ekonomia informale vazhdon të jetë një pengesë për rritjen e prodhimit dhe aftësinë konkurruese (Banka Botërore, 2024). Formalizimi i NVM-ve është thelbësor për qasje në financime dhe ulje të rreziqeve rregullatore.



Kapitali njerëzorë, dixhitalizimi dhe punësimi.

Tregu i punës në Kosovë përballlet me sfida strukturore, papunësi të lartë dhe pjesëmarrje të ulët të grave në tregun e punës (Banka Botërore, 2024). Investimet ndërkombëtare kërkojnë fuqi punëtore produktive dhe të aftë.

Bizneset duhet të zbatojnë politika që përmirësojnë pjesëmarrjen e grave dhe qasjen në kujdesin ndaj fëmijëve, si dhe të investojnë në edukimin e hershëm.

Dixhitalizimi mbetet parakusht për rritje afatgjatë dhe tërheqje të investimeve (Komisioni Evropian, 2025). Integrimi i sistemeve të të dhënave dhe optimizimi i proceseve operacionale rrit efikasitetin dhe përgatit bizneset për kërkesat globale.

Kombinimi i dixhitalizimit, zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe përputhjes me standardet ndërkombëtare do të përcaktojë suksesin e bizneseve kosovare në vitin 2026 dhe më tej.

Let's connect



bakertillyks.com



Baker Tilly Kosovo



Baker Tilly Kosovo

Information in this document is subject to change and should not replace tailored professional advice.
Baker Tilly Kosovo assumes no liability for its use. © Baker Tilly Kosovo.

Seattle sunrise skyline silhouette view with urban office buildings designed by TravelScape - Freepik.com for prospectinteractive. Aerial view of group of business people working together and preparing new project on a meeting in the office designed by boggy - Freepik.com for prospectinteractive. Businesspeople shaking hands designed by wavebreak media_micro - Freepik.com for prospectinteractive. businessman in a summer city with woman designed by prostooleh - Freepik.com for prospectinteractive. European parliament building in brussels designed by EyeEm - Freepik.com for prospectinteractive. Discussing charts designed by pressfoto - Freepik.com for prospectinteractive. Embark on an exhilarating mountain adventure Natures vastness welcomes travelers to explore designed by arshakaputra32 - Freepik.com for prospectinteractive.

Now, for tomorrow.